



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik

Zyra e Kryetarit

01-Nr. 104/01-3865/18
Kaçanik, 05.02.2018

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të komunës së Kaçanikut, pas propozimit të Drejtorisë e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike, kryetari i komunës nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat e fundit shiut (nga 03.02. - 04.02.2018), me këtë përbërje:
 1. Bujar Bajra, DESHP
 2. Menduh Krasniqi, DESHP dhe
 3. Hajredin Shehu, DESHP
- II. Obligohet komisioni që të dal në vend-ngjarje dhe të bëjë vlerësimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara, me koston e dëmeve.
- III. Në rastet më të rënda, komisioni kërkon ndihmë shtesë nga zyra e kryetarit apo drejtoritë përkatëse.
- IV. Komisioni aktivizohet nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, si dhe për punën e vet raporton tek kjo drejtori.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Besim Ilazi


Kryetar i Komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Ramadush Osmani, Drejtori i DESHP
- Anëtarët e Komisionit dhe Arkivi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës

01-08Nr. 320/01-4021/18

Kaçanik, 06.02.2018

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale, Rregulloren Komunale 2007/30, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NË BUJQËSI NGA FATKEQËSITË NATYRORE

I

Me këtë vendim formohet komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, në territorin e Komunës së Kaçanikut me këtë përbërje:

1. Zylfi Koxha, Koordinator i Sektorit të Bujqësisë
2. Mustafë Loku, Zyrtar për Bujqësi dhe Blegtori
3. Zekirja Koxha, Zyrtar për Zhvillim Rural

II

Komisioni ka për detyrë të dalë në teren, të evidentoj dhe vlerësoj dëmet e shkaktuara në bujqësi nga fatkeqësit natyrore (reshjet, breshërit, ngricat e hershme etj.) dhe të hartoj raport me shkrim, me të cilin njoftohen Kryetari i Komunës dhe Drejtori për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

III

Me këtë Vendim njoftohen : Arkivi i Komunës, DBZHRP-së, dhe anëtarët e komisionit.



Kryetari i Komunës

Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS

01NR. 10402-1964 2018

Kaçanik.

Në bazë të nenit 13 të Ligjit të vetëqeverisjes lokale, Rregulloren (QKR) Nr.13/2017 për riintegrimin e Personave të Riatdhesuar neni 27 pika 1,2,3,4 i kësaj Rregullore, Strategjisë Komunale për riintegrimin e personave të riatdhesuar Kryetari i Komunës merr Këtë :

V E N D I M

I

Themelohet Komisioni Komunal për riintegrim me këtë përbërje:
Diana Reka Drejtoresh e DSHMS-sës, Kryesuese e Komisionit; Fadil Guri (ZKKK); Hajrush Dullovi(DAK); Menduh Krasniqi(DSHP); Hidajete Hoxha(Zyrtare e integritimeve Evropiane); Vedat Dema (Zyrtar për të drejtat e njeriut); Jehona Dërvishi (DUKMM)

II

Komisioni komunal për riintegrim merr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitime emergjente si dhe masat për mbështetjen e riintegrit të qëndrueshëm sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje

III

Komisioni Komunal për riintegrim duhet të jetë efektiv dhe efikas gjatë ushtrimit të kompetencave për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe të vendos brenda kohës sa më të shkurtë të mundshme por jo më gjatë se 7 ditë nga data e pranimit të kërkesës për skemat emergjente , kurse për skemat tjera vendimet mirren brenda 15 dite nga dita e pranimit të kërkesës.

IV

Me këtë vendim njoftohen Zyra e Kryetarit, antarët e komisionit dhe Zyra Komunale për kthim dhe komunitete



Kryetar i Komunës Kaçanik
z.Besim Ilazi